



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” ADMINISTRATORI

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës, personel administrativ, **Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve** në *Drejtorinë e Prokurimeve dhe Shërbimeve* në Rektorat.

Personeli administrativ: **Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve** në *Drejtorinë e Prokurimeve dhe Shërbimeve*: përgjigjet për mbarëvajtjen e punës në këtë sektor duke koordinuar punën midis drejtorit dhe specialistëve e punonjësit e tjerë të sektorit; u jep zgjidhje ligjore dhe teknike problemeve brenda sektorit duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë drejtorisë; zgjidh mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencat për ndjekjen e problemeve duke bashkëvepruar me drejtorinë e drejtorisë; raporton tek drejtori, harton raporte, kryen analiza periodike si dhe me përpikmëri e nivel të lartë përgjegjshmërie brenda afateve detyrat që i ngarkohen.

### **Kritere të përgjithshme:**

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master i Shkencave) apo ekuivalente me të, në shkenca të natyrës (ekonomi). Diplomat e ciklit të parë duhet të jenë të së njëjtës fushë studimi me atë të ciklit të dytë. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të ketë përvojë pune.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë

### **Kritere të veçanta:**

- Të ketë jo më pak se një vit pune në pozicion drejtues ose të ngjashëm me të.
- Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite pune në profesion.
- Të ketë kryer kurse apo kualifikime në fushën ekonomike/financiare/manaxheriale brenda e jashtë vendit.
- Të ketë njohuri të mira të një gjuhe të huaj perëndimore.
- Të jetë njohës dhe përdorues programeve kompjuterike.
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në *Drejtorinë e Burimeve Njerëzore* Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” **brenda 10 (dhjetë) ditëve (21 – 30.09.2020)** nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
ADMINISTRATORI**

- Letër motivimi për pozicionin e punës *Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve* në Drejtorinë e Prokurimeve dhe Shërbimeve
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Referenca pune nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (**21 – 30.09.2020**) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,  
Aplikim për pozicionin e punës: *Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve*  
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Rektoratit**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve (01.10.2020 – 05.10.2020) dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë. Kandidatët konkuroes do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe brenda datës 16.10.2020 edhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në adresën elektronike, [burimetnjerezore@uniel.edu.al](mailto:burimetnjerezore@uniel.edu.al).